SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje

me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në

përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofuara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)
1	Altoparlant 10 inch	170		
2	Altoparlant 12 inch	160		
3	Altoparlant pasiv me mundësi për t'u varur (Line Array) 8 inch	32		
4	Altoparlant pasiv me mundësi për t'u varur (Line Array) 10 inch	32		
5	Altoparlant pasiv me mundësi për t'u varur (Line Array) 12 inch	20		
6	Mbajtëse për sistem audio line array 8 inch	32		
7	Mbajtëse për sistem audio line array 10 inch	32		
8	Mbajtëse për sistem audio line array 12 inch	20		
9	Amplifikator fuqie 8 kanale	16		
10	Mbajtëse për sistem audio me frekuencë të ulët line array	20		

11	Altoparlant 15 inch	40		
12	Altoparlant me frekuencë të ulët 18 inch	20		
13	Altoparlant me frekuencë të ulët 2*18 inch	20		
14	Altoparlant me frekuencë të ulët me mundësi për t'u varur (Line array) 18 inch	20		
15	Amplifikator fuqie 4 kanale	16		
16	Procesor audio	16		
17	Spliter audio 16 kanale	25		
18	Spliter audio 32 kanale	20		
19	Sistem distributorësh antenash	25		
20	Pult fonie dixhital 16 kanale	30		
21	Pult fonie dixhital me 32 kanale	20		
22	Mikrofon valor	220		
23	Mikrofon për fjalime	100		
24	Mikrofon instrumenti	120		
25	Mikrofon vokali me kabëll	60		
26	Set mikrofonash për bateri	25		
27	Mikrofon foltoreje	120		
28	Mikrofon për prezantues	25		
29	Mikrofon konference	300		
30	Përforcues sinjali audio	41		
31	Shpërndarës sinjali audio	41		
32	Personal mixer	20		
33	In ear monitor	19		
34	Stativ mikrofoni	100		
35	Stativ boksi	200		
36	Lexhio mbajtëse partiturash	30		
37	Kartë zëri për regjistrimin e audios	25		
38	Sistem përkthimi me infra	16		
39	Sistem përkthimi	16		

40	Kabin përkthimi me certifikim ISO 4043	25		
41	Marrës valor për sistemin e përkthimit	1,200		
42	Përkthyes	50		
43	Set paisjesh për DJ	6		
44	Modul Ekrani led me rezolucion jo më shumë se 2.6 mm (për ambjent të brendshëm)	500		
45	Modul Ekrani led me rezolucion jo më shumë se 4 mm (për ambjent të brendshëm dhe të jashtëm)	400		
46	Modul Ekrani led me rezolucion jo më shumë se 5 mm (për ambjent të jashtëm)	300		
47	Strukturë mbajtëse për Ekranin Led	1,000		
48	Efekte Speciale me Ndriçues Linear Inteligent (1 m)	80		
49	Tub ndriçues 360 gradë dekorativ me bateri (1 m)	40		
50	Ndriçues dekorativ	250		
51	Roll up Elektronik (poster LED)	6		
52	Videoprosesor	100		
53	Server video	30		
54	Laptop	250		
55	Pult per slide e powerpoint	30		
56	Televizor 50"	20		
57	Televizor 65"	12		
58	Televizor 84" interaktiv	8		
59	Televizor 55" interaktiv	15		
60	Projektor 20000 ansli lumen	4		
61	Projektor 6500 ansli lumen	8		
62	Projektor 30000 ansli lumen	3		
63	Copë projektimi me përmasa të ndryshme (6 m*4m; 4m*3m;3m*2m)	8		
64	Ndriçues profile LED +lente	40		

65	Ndriçues Led 100 cmRGBU, kontroll individual px	120		
66	Robot Spot IP65 420w	30		
67	Robot Spot 700w	30		
68	Robot Beam me rreze 189w	40		
69	Robot Beam 280w	40		
70	Robot wash me unaze pixel, IP65	50		
71	Ndriçues wash rgb	200		
72	Dritë e bardhë mediatike	200		
73	Mikser ndriçimi 14 fader me prekje	16		
74	Mikser ndriçimi 30 fader automatizuar	14		
75	Mikser ndriçimi 45 fader të motorizuar me ekran të gjerë	8		
76	Mikser ndriçimi 20 fader	8		
77	Skeleri trekëndore	200		
78	Vinça manual 5 m/150 kg	30		
79	Followspot 2500 w	8		
80	Robot Beam 440w IP65	30		
81	Tym skenik	10		
82	Splitter DMX	80		
83	Procesor ndriçimi	20		
84	Fan Storm	16		
85	Skela hekuri 2*2*2 për mbajtjen e ndriçimit	30		
86	Kanelina gome për mbulimin e kabujve	150		
87	Strukturë truss e zezë	25		
88	Podium me lartësi të ndryshme	1,600		
89	Barriera MOJO	73		
90	Ndarës (barriera)2*1	60		
91	Panel korenti 400 amper	4		
92	Panel korenti 125 amper	10		

93	Panel korenti 63 amper	30		
94	Panel korenti 32 amper	40		
95	Panel korenti 16 amper	54		
96	Gjenerator 360 Kw	3		
97	Gjenerator 80 Kw	4		
98	Çadër me përmasa 3*3	8		
99	Çadër me përmasa 5*5	8		
100	Çadër me përmasa 4*4	15		
101	Çadër e madhe me lartësi mbi 5 m	300		
102	Foltore me led	6		
103	Foltore e branduar	50		
104	Tapet /Moket	800		
105	Baner me strukturë	200		
106	Karrige	2,500		
107	Tavolinë	30		
108	Tavolinë plexiglass	30		
109	Tavolin DJ	8		
110	Teknik audio	120		
111	Teknik video	120		
112	Teknik ndriçimi	120		
113	Teknik podiumi	120		
114	Inxhinier audio	16		
115	Shërbim konference online	6		
116	Skenë e mbuluar 8*6	6		
117	Strukturë skenike	300		
118	Rack amplifikatorësh për foni 40.000 watt	3		
119	Altoparlant me frekuenca të ulta me 2 altopolante 18 inch me mundësi varje	12		
120	Mikse audio me 64 kanale	12		
121	Mikse audio me 72 kanale	6		

122	Mikse audio me 96 kanale	4		
123	Sistem Monitorimi	3		
124	Strobe me LED 1000w IP 65	40		
125	Blinder 2 light	40		
126	Blinder 4 light	40		
127	Robot Profile	20		
128	Motorr /Vinça me kapacitet mbajtës deri në 1 ton	40		
	Çmimi total (Mallrat)			
	Çmimi Neto pa TVSH			
	TVSH (%)			
	Çmimi total me TVSH:			
	Emri i përfaqësuesit të ofertuesit			
	Nënshkrimi			
	Vula			
	Date _____			

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi**

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, pika 3/b, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.

Nëse ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN, mbi komformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

-
1. **Altoparlant 10 inch:** Altoparlant dy rrugësh me altoparlant 10" dhe frekuencë të lartë 1" me amplifikator të integruar. Altoparlanti të ketë fuqi të paktën 500 watt dhe nivel decibel të paktën deri në 122dB.
 2. **Altoparlant 12 inch:** Altoparlant dy rrugësh me altoparlant 12" dhe frekuencë të lartë deri në 3". Altoparlanti të ketë fuqi të paktën 900 watt dhe nivel decibel të paktën deri në 130dB.
 3. **Altoparlant pasiv me mundësi për t'u varur (Line Array) 8 inch:** Altoparlant pasiv 2 rrugësh me dy altoparlante me përmasa 8" secili për frekuencat e ulëta dhe një altoparlant me përmasa 3" i kompresuar për frekuencat e larta. Të ketë fuqi të paktën 350watt. Altoparlanti të vijë në formë "Line Array" me të gjithë aksesoret e nevojshëm për ta varur në lartësi dhe për të kombinuar të paktën 12 copë së bashku. Niveli i presionit të zërit të arrijë të paktën 142dB. Brezi i frekuencave që duhet të riprodhojë të jetë mbi 40Hz deri në minimalisht 18kHz.
 4. **Altoparlant pasiv me mundësi për t'u varur (Line Array) 10 inch:** Altoparlant me 3 drejtime që përbëhet nga altoparlant 2 x 10 10 LF | 2 x 8 " MF | 1 x 3 " HFS. Me fuqi minimalisht 400W. Altoparlanti të vijë në formë "Line Array", me të gjithë aksesoret e nevojshëm për ta varur në lartësi dhe për të kombinuar të paktën 12 copë së bashku.
 5. **Altoparlant pasiv me mundësi për t'u varur (Line Array) 12 inch:** Altoparlant me 3 drejtime që përbëhet nga altoparlant 2 x 12", 4x6.5 ", 2 x 3 ". Altoparlanti të vijë në formë "Line Array", me të gjithë aksesoret e nevojshëm për ta varur në lartësi dhe për të kombinuar të paktën 12 copë së bashku. Brezi i frekuencave që duhet të riprodhojë të jetë mbi 35Hz deri në minimalisht 20kHz. Niveli i presionit të zërit të arrijë të paktën 147dB.
 6. **Mbajtëse për sistem audio line array 8 inch:** Strukturë alumini për mbajtjen e sistemit line array, ngarkesa maksimale për 24 bokse line array për sistem të vogël audio.
 7. **Mbajtëse për sistem audio line array 10 inch:** Strukturë alumini për mbajtjen e sistemit line array, ngarkesa maksimale për 16 bokse line array për sistem të mesëm audio.
 8. **Mbajtëse për sistem audio line array 12 inch:** Strukturë alumini për mbajtjen e sistemit line array për të montuar deri në 12 bokse me dy motorë.
 9. **Amplifikator fuqie 8 kanale:** Numri i kanaleve: 8 Fuqia e daljes (për kanal), Modaliteti me një kanal: 5200 W @ 2 Ω, 3000 W @ 4 Ω, 1600 W @ 8 Ω Modaliteti i urës: 10400 W @ 4 Ω, 6000 W @ 8 Ω Tensioni i daljes maksimale :175 V Rryma maksimale e daljes 130A Tensioni operativ : 85V -440V Diapazoni i Frekuencës : 5 Hz – 30 kHz.
 10. **Mbajtëse për sistem audio me frekuencë të ulët line array:** Strukturë alumini për mbajtjen e sistemit line array, ngarkesa maksimale për 12 bokse line array.
 11. **Altoparlant 15 inch:** Altoparlant dy rrugësh me altoparlant 15" dhe frekuencë të lartë deri në 3". Altoparlanti të ketë fuqi të paktën 900 watt dhe nivel decibel të paktën deri në 133dB.
 12. **Altoparlant me frekuencë të ulët 18 inch:** Altoparlant me frekuencë të ulët me fuqi 1600watt. Me fuqi minimalisht 1600 watt rms. Përmasat e altoparlantit të jetë 18". Altoparlanti të jetë i përshtatshëm për tu varur në lartësi (Line Array) dhe të vijë me të gjithë aksesoret e nevojshëm, sigurojnë montimin e tij në skenë. Brezi i frekuencave që boksi duhet të arrijë të riprodhojë të jetë të paktën 35 Hz deri në 110 Hz. Niveli i presionit të zërit të arrijë të paktën 139 dB.
 13. **Altoparlant me frekuencë të ulët 2x18 inch:** Subwoofer me dy altoparlantë 18 inç me drejtues ekskursioni të lartë dhe ajrim laminar të optimizuar për të maksimizuar efikasitetin LF - i vendosur në modele të gjithë drejtimit ose kardiod në konfigurime të grumbulluara. Brezi i frekuencës (-10 dB) 28 Hz – 160 Hz. Niveli i presionit të zërit të arrijë të paktën 143 dB.
 14. **Altoparlant me frekuencë të ulët me mundësi për tu varur (Line Array) 18 inch:** Subwoofer me dy altoparlantë 18 inç me drejtues ekskursioni të lartë dhe ajrim laminar të optimizuar për të maksimizuar efikasitetin LF - i vendosur në modele të gjithë drejtimit ose kardiod në konfigurime të grumbulluara. Brezi i frekuencës (-10 dB) 28 Hz – 160 Hz. Niveli i presionit të zërit të arrijë të paktën 143dB. Altoparlanti të vijë në formë "Line Array", me të gjithë aksesoret e nevojshëm për ta varur në lartësi dhe për të kombinuar të paktën 12 copë së bashku.
 15. **Amplifikator fuqie 4 kanale:** Amplifikator digjital që të ketë të paktën 4 hyrje sinjali dhe 4 dalje fuqie me të paktën 1000 watt RMS për secilën dalje në rezistencën 4 ohm.
 16. **Procesor audio:** Procesori të bazohet në teknologjinë FPGA, do të ketë në dispozicion njëkohësisht 216 x 216 kanale, Ai do të jetë në gjendje të përpunojë audio 96 kHz me një rezolucion deri në 64

bit (AES3 nga 32 kHz në 192 kHz, Dante 48 kHz ose 96 kHz, MADI nga 44.1 kHz në 96 kHz) dhe do të sigurojë mundësinë e marrjes së mostrës në Dalja 48 kHz për burim.

17. **Spliter audio 16 kanale:** është një rack I / O i pajisur me Dante me 64 inpute dhe 16 dalje analoge, 8 dalje AES / EBU. Spliteri mund të përdoret si një kuti I / O gjenerike për rrjetin Dante.
18. **Spliter audio 32 kanale:** është një rack I / O i pajisur me Dante me 32 inpute dhe 24 dalje Spliteri mund të përdoret si një kuti I / O gjenerike për rrjetin Dante.
19. **Sistem distributoresh antenash:** Sistem aktiv i shpërndarjes së antenave me diversitet uhf, me brez të gjerë 470-990 mhz.
20. **Pult fonie dixhital 16 kanale:** Mikser audio digjital. Mikser audio digjital me të paktën 16 kanale mikrofonike, 8 kanale dalje të balancuara dhe 40 hyrje në total. Të ketë të paktën 17 shina të cilat duhet të jenë të motorizuara. Mikseri të ketë një ekran me përmasa të paktën 5" që shfaq të gjithë parametrat teknik që ndryshohen nga operatori.
21. **Pult fonie dixhital me 32 kanale:** Mikser audio digjital. Pulti duhet të ketë të paktën 32 hyrje mono si dhe 32 shina të motorizuara. Pulti të ketë 32 hyrje dhe 16 dalje analoge. Pulti duhet të kontrollohet me protokollin Dante Controller. Pulti të shoqërohet me një "stagebox" i cili krijon mundësi për të shtuar dhe 32 hyrje dhe 16 dalje. Pulti të ketë të integruar një ekran dixhital me anë të të cilit të kontrollohen dhe të rregullohen parametra të ndryshëm. Pulti të krijojë mundësinë që të kryejë regjistrim multi-track me 32 kanale. Pulti duhet të krijojë mundësi për procesim zëri në çdo hyrje dhe dalje.
22. **Mikrofon valor:** Mikrofon valor që përdoret për fjalime dhe muzikë. Mikrofonit të vijë bashkë me bazën që shërben për marrjen e sinjalit. Baza duhet të suportoje të paktën 2 mikrofone që funksionojnë njëkohësisht. Sistemi valor duhet të jetë tërësisht digjital. Mikrofonit duhet të suportoje inkriptimin e sinjalit të transmetuar me kapacitetin 512-BIT. Baza e mikrofonit, veç daljes analoge të sinjalit, duhet të ketë edhe dalje digjitale si DANTE dhe AES EBU. Brezi i frekuencave që duhet të suportoje mikrofonit: 25–20 000Hz.
23. **Mikrofon për fjalime:** Mikrofon i përshtatshëm për fjalime. Mikrofonit ka një bazë të tijen që e suporton për të qëndruar në tokë. Trupi i mikrofonit suportohet nga një stativ me lartësi të paktën 60cm. Trupi i mikrofonit duhet të jetë elegant dhe i kontrollueshëm në gjatësi për tu përshtatur në bazë të gjatësisë së folësit. Mikrofonit duhet të suportoje brezin e frekuencave 50~18,000 Hz.
24. **Mikrofon instrumenti:** Mikrofon për instrument frymor që mund të kapet në instrument. Mikrofonit të jetë me kondesator dhe të funksionojë me 9 deri në 52 volt. Brezi i frekuencave që duhet të funksionojë: 60 - 20 kHz. Polariteti të jetë kardiod.
25. **Mikrofon vokali me kabell:** Mikrofon vokali dinamik me kabell. Polariteti super kardiod. Brezi i frekuencave 50 Hz – 16 kHz. Mikrofonit të jetë i përshtatshëm për tu përdorur në koncerte dhe këngëtarë live.
26. **Set mikrofonash për bateri:** Seti i mikrofonave për bateri të përbëhet nga të paktën 7 mikrofone që të shërbejnë për të kapur një gamë të gjerë instrumentesh si drum, bas drum, overhead për baterinë dhe mikrofon për amplifikatorë kitare.
27. **Mikrofon foltoreje:** Mikrofon për foltore me gjatësi 40cm. Kapsula e mikrofonit të jetë e çmontueshme për të mundësuar instalimin e disa kapsulave të ndryshme. Mikrofonit të shoqërohet me kapsulë kardioide dhe super kardioide.
28. **Mikrofon për prezantues:** Mikrofonit për prezantues është i montueshëm në pjesën e kokës. Të ketë të paktën dy kapje që mbështeten në vesh. Mikrofonit dhe kapsula të kenë ngjyrë bezhë të hapur. Polariteti i kapsulës të jetë super kardiod. Mikrofonit të shoqërohet me një transmetues valor që montohet në trup dhe një marrës valor që shërben për marrjen e sinjalit të transmetuar.
29. **Mikrofon konference:** me gjatësi shufre 50cm. Mikrofonit delegatësh të përshtatshëm për konferenca. Mikrofonit të shoqërohet me një njësi transmetimi i cili bën të mundur lidhjen me njëri-tjetrin deri në 50 mikrofonash njëkohësisht dhe me përdorim deri në 5 mikrofone njëkohësisht. Mikrofonit të shoqërohet dhe me bazën e tij i cili bën të mundur aktivizimin dhe çaktivizimin e tij nëpërmjet një butoni sipas dëshirës së delegatit. Brezi i frekuencave të jetë 50 Hz-20kHz.
30. **Përforcues sinjali audio:** Përforcuesi i sinjalit audio të ketë të paktën dy hyrje Jack ¼" dhe një hyrje XLR. Përforcuesi duhet të stabilizojë dhe balancojë sinjalin audio që vjen direkt nga instrumentet muzikore.
31. **Shpërndarës sinjali audio:** Shpërndarës sinjali fonie dixhital me të paktën 32 kanale hyrëse dhe 16 kanale dalje. Të ketë të paktën 2 dalje dixhitale AES/EBU me konektorë XLR të balancuar. Secili kanal hyrës, me konektorë XLR të balancuar, të ketë opsion për aktivizim fuqie +48V për mikrofonat që kërkojnë "phantom power".

-
32. **Personal mixer:** Dalja audio 1/4" TRS stereo, niveli i kufjeve ose i linjës; 1/8" stereo TRS, niveli i kufjeve ose i linjës; XLR i balancuar mono, niveli i linjës. Konvertimi digjital në analog dhe thellësia e bitit 44,1/48 kHz, 24-bit Stereo Operation Stereo Link, për çift kanali; Dalja e kufjeve 1.0 wat në 100 ohms (Dalja e linjës/kufjeve Impedanca e daljes 32 ohms Brezi i frekuencës 2-22 kHz +0,2dB/-3dBTHD+N < 0,003% Sinjali në zhurmë (i papeshuar) -106dB (i matur me zero të dhëna në të gjitha kanalet)
33. **In ear monitor:** Sistemi i përgjithshëm Brezi i frekuencave të funksionimit DF2: 470,125 deri në 607,875 MHz Banda EG2: 580.000 deri në 713.850 MHz Hapi i frekuencës minimale 25 kHz Modaliteti i modulimit FM Devijimi nominal/pika ± 34 kHz nominale / ± 45 kHz maja Brezi i frekuencës 40 Hz deri në 14,100 Hz Ndarja Stereo 75 dB Gama e funksionimit 90 m (300') Transmetues IEM Fuqia e daljes RF e lartë: 50 mW, e ulët: 10 mW (e ndërrueshme) në 50 ohms Furnizimi me energji elektrike 100 deri në 240 V AC (50/60 Hz) deri në 12 V DC 1 A (në qendër pozitive) Furnizimi me energji i jashtëm i ndërruar Dalja e antenës e tipit BNC, 50 Marrësi Diversiteti i Antenës së Sistemit Marrës Kablloja e daljes së audios funksionon si një antenë dytësore për të siguruar performancë të qëndrueshme RF Refuzimi i imazhit >80 dB, tipik Ndjeshmëria ndaj RF 20 dBuV në raportin S/N 60 dBA (përfundimi 50 ohms) Dalja e kufjeve mini-fole stereo TRS 3,5 mm (1/8") Dalja e kufjeve 40 mW (në 12 ohm) EQ i ulët: 80 Hz / 160 Hz / 320 Hz / ± 9 dB në hapin 3 dB Lartë: 6 kHz / 8 kHz / 10 kHz / ± 9 dB në hapin 3 dB Kufizues i përzgjedhshëm: -30dB në OFF (0 dB) në hapa 6 dB
34. **Stativ mikrofonit:** Stativ metalik që shërben për mbajtjen e mikrofonit.
35. **Stativ boksi:** Stativ metalik që shërben për mbajtjen e boksit.
36. **Lexhio mbajtëse partiturash:** Stativ metalik që shërben për mbajtjen e partiturave për artistët.
37. **Kartë zëri për regjistrimin e audios:** Kartë regjistrimi për zërin e audios.
38. **Sistem përkthimi me infra:** Pajisja duhet të jetë e pajisur me një ekran 7 inç me rezolucion 800 x 480 dhe një gamë frekuencash nga 100 – 20,000 Hz. Duhet të ketë nivel maksimal hyrës akustik prej 110 dB SPL, fuqinë e daljes 65 mW, konsumi 15 W energji.
39. **Sistem përkthimi:** Sistem përkthimi me 12 output me konsum energjie për njësi 100mA $\pm$ 10mA. Niveli i output për kufje 120mV $\pm$ 10mV në 33 Ω . Ndjeshmëri mikrofonash -45dB $\pm$ 2dB.
40. **Kabinë përkthimi me certifikim ISO 4043:** Kabinë përkthimi me hapësirë për 2përkthyes. Të krijohet mundësia për pamje vizuale për përkthyesit edhe nëse kabina nuk ka shikueshmëri të drejtpërdrejtë të folësit. Kabina të shoqërohet me certifikatë origjinalitetit.
41. **Marrës valor për sistemin e përkthimit:** Kufje për sistem përkthimi + transmetues me frekuencë devijimi ± 48 KHz dhe me lidhje mikrofonit 1/8" Mono Phone Jack. Jetëgjatësi baterie 14 orë. Stabilitet ± 10 KHz.
42. **Përkthyes:** Përkthyes të liçensuar për përkthimin e gjuhëve të ndryshme, në varësi të kërkesës së Autoritetit Kontraktues.
43. **Set pajisjesh për DJ:** Set pajisjesh për DJ për performancë e DJ (cd player + mixer)
44. **Modul Ekranit Led me rezolucion jo më shumë se 2.6 mm (për ambient të brendshëm):** Modul Ekran LED me rezolucion jo më shumë se 2.6mm (për ambient të brendshëm). Ekranit LED është i përshtatshëm për video dhe imazhe të formateve të ndryshme.
45. **Modul Ekranit Led me rezolucion jo më shumë se 4 mm (për ambient të brendshëm dhe të jashtëm):** Largësia e pixelave nuk duhet të kalojë 4mm. Ekranit LED është i përshtatshëm për video dhe imazhe të formateve të ndryshme.
46. **Modul Ekranit Led me rezolucion jo më shumë se 5 mm (për ambient të jashtëm):** Largësia e pixelave nuk duhet të kalojë 5 mm. Ekranit LED është i përshtatshëm për video dhe imazhe të formateve të ndryshme.
47. **Strukturë mbajtëse për Ekranin Led:** Strukturë alumini për mbajtje peshe. Struktura të jetë lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme në përmasa të rregulluara sipas kërkesave të ekranit led.
48. **Efekte speciale me Ndriçues Linear Inteligent (1m):** Ndriçim linear për ambient të jashtëm dhe të brendshëm i përshtatshëm me aksesore për të arritur forma të ndryshme. Ndriçuesi të jetë me përmasa 1 m dhe me peshë jo më shumë se 2 kg me ngjyra rgb.
49. **Tub ndriçues 360 grade dekorativ me bateri (1m):** Ndriçues led tubolar rgb dekorativ për të krijuar dekore skenike. Me dritë 360 grade, me bazament të integruar.
50. **Ndriçues dekorativ:** Ndriçues dekorativ skenik me ngjyre të ngrohte. Mundësi dritë të dimerueshme. Pajisja të jetë e përbërë nga 7 llampa me fuqi nga 12watt-60watt.

-
51. **Roll up Elektronik (Poster LED):** Panel alumini, me ekran Led me nivel ndricimi nga 1000 cd deri ne 3100 cd, me permasa perafersisht 2 m lartesia me 0,7 m gjeresia, i pershtatshem per te shfaqur imazhe dhe video te ndryshme. Largesia e pixelave nuk duhet te kaloje 2,5mm.
 52. **Videoprosesor:** Procesor video per perdorimin e Ekranit Led. Procesori i videos duhet te kete mundesine per hyrje dvi,vga dhe usb.
 53. **Server Video:** Mediaserver, te kete te pakten 20 layer full hd 1080p, hyrje video te pakten 1 hd-sdi, 1 hdmi dhe 2 vga. Dalje video te pakten 2 dvi,1 hdmi dhe 2 vga.
 54. **Laptop:** Laptop video për të bërë të mundur shfaqjen e imazheve video ne led wall
 55. **Pult per slide e powerpoint:** Pult per te bere te mundur ndryshimin e slide-ve ne led wall/TV/Copë projektori
 56. **Televizor 50":** Ekran Televizori 50". Rezolucioni i ekranit eshte full HD LED me format 16:9, Smart TV.
 57. **Televizor 65":** Ekran Televizori 65". Rezolucioni i ekranit eshte full HD LED me format 16:9, Smart TV.
 58. **Televizor 84" interaktiv:** Ekran Televizori 84" me ekran me prekje. Rezolucioni i ekranit eshte full HD LED me format 16:9, Smart TV.
 59. **Televizor 55" interaktiv:** Ekran Televizori 55" me ekran me prekje. Rezolucioni i ekranit eshte full HD LED me format 16:9, Smart TV
 60. **Projektor 20000 ansli lumen:** Projektor me intensitet drite të paktën 20,000 me lente me kënd të gjerë. Rezolucioni 4k.
 61. **Projektor 6500 ansli lumen:** Projektor me intensitet drite të paktën 6500 ansi Lumen. Kontrasti të paktën 5000:1. Rezolucioni FullHD. Projektori të ketë disa hyrje video, si HDMI, DVI.
 62. **Projektor 30000 ansli lumen:** Projektor me intensitet drite të paktën 30,000 me lente me kënd të gjerë. Rezolucioni 4k.
 63. **Copë projektimi me përmasa të ndryshme (6mx4m; 4mx3m; 3mx2m):** Copa e projektimit të ketë përmasa të ndryshme në varësi të eventit 6mx4m; 4mx3m; 3mx2m.
 64. **Ndriçues Profile LED + lente:** Prozhektor Profile me Led me ngjyra të plota, te ofroje një gamë të plotë ngjyrash. Me motor LED te prodhuar posaçërisht për të siguruar një spektër të plotë dhe dalje të plotë në mjediset më të shquara, pavarësisht se cilin rol po luan.
 65. **Ndriçues LED 100cm RGBW, kontroll individual px:** Të kontrollueshme individualisht për përdorim të jashtëm BURIM DRITE. Burimi: LED RGBW 15x10W Fluksi i ndritshëm: (16° + i shpërndarë) 4'983 lm - (16°) 5'394lm @plot Luks: (16° + i shpërndarë) 1'886 lm - (16°) 2'454lx @5 m plot Sistemi i ngjyrave. Përzierja e ngjyrave: RGBW / FC CCT: Kontroll CCT përmes kanalit të dedikuar DMX Paracaktimet e bardha: 2,800 K - 10,000 K Rrota me ngjyra: Rrota virtuale e ngjyrave me makro Makrot: disa makro pikselë të ndërtuar paraprakisht me shpejtësi të rregullueshme KONTROLLI Protokollet: DMX512 Kanalet DMX: 4 / 6 / 10 / 60 / 65 kanale Kontrolli i pikselit: kontrolli me piksel 2 piksel.
 66. **Robot Spot IP65 420W:** Robot me zmadhim dhe përzierje ngjyrash LED lëvizës i fuqishëm dhe fleksibël: IP65 e vlerësuar për ngjarje në natyrë dhe instalime të përkohshme. LED me fuqi të lartë 420 W me CT 7.000 K dhe zmadhim linear 5° - 50°. Gama e gjerë e efekteve duke përfshirë përzierjen lineare CMY dhe CTO, rrotën e ngjyrave, rrotën rrotulluese gobo, rrotën statike gobo, prizmat rrethore, ngrirjen lineare dhe fokusin.
 67. **Robot Spot 700 W:** Njësia optike me efikasitet shumë të lartë të shkëlqimit (35,000 lux në 5 m) Temperatura e ngjyrave: 7,200 K Fluksi i ndriçimit: 50.000 lm, 14.7 ° - 35 ° zmadhim linear elektronik dhe lente fushore uniforme në një kanal të dedikuar.
 68. **Robot Beam me rreze 189W:** te jete me rreze 189W me një shkëlqim të pashembullt zakonisht të arritshëm vetëm me fuqi më të madhe. Te peshoje jo me shume se 16 kg, Te prodhoje një rreze të përkryer paralele, me rreze laser, me një prodhim të prej 59.760 lx në. Te Ofroje 14 ngjyra të ndryshme dhe 17 gobos, duke lejuar të ndryshohet forma e rrezes dhe të krijohet një sërë efektsh mes ajrit.
 69. **Robot Beam 280W:** Llambë shkarkimi minimalisht 280 W me një sistem optik të personalizuar Diapazon i zmadhimit masiv nga 2 ° në 23 ° me modalitetet e rrezes dhe pikes. Rrota me 13 pozicione duke përfshirë filtrat CTC. Efektet e gjera përfshijnë: rrota rrotulluese gobo, rrota statike gobo, prizmat e dyfishtë dhe acari linear.
 70. **Robot wash me unazë pixel, IP65:** IP65 për aplikim të përkohshëm në natyrë, jo për instalim fiks. 19 LED RGBW / FC Osram 40W dhe unazë e jashtme pikselësh RGB. Gama e zmadhimit linear masiv prej 4,5° deri në 36° nga rreze në larje. Kontroll individual pikselësh me gjenerator FX në

bord për LED dhe unazë pixel për efekte të shpejta dhe precize. Sistemi i ftohjes së tubave të nxehtësisë për ftohje efikase praktikisht pa zhurmë.

71. **Ndricues wash rgb:** Ndricues wash jo i motorizuar dhe të ketë të paktën 4 LED RGB me nga 30 watt secili. Këndi i dritës të jetë të paktën 60°. Ndricuesi të kontrollohet me protokollin DMX.
